URDHËR
Nr. 321, datë 11.2.2014

PËR PËRFUNDIMIN E PERIUDHËS KALIMTARE, NË KRYERJEN E FUNKSIONEVE TË DHËNA, AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT, NGA LIGJI NR. 10 448, DATË 9.6.2011 "PËR LEJET E MJEDISIT"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", të nenit 4 dhe të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 29.1.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit",

URDHËROJ:

1. Përfundimin e periudhës kalimtare në kryerjen e funksioneve Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të dhëna nga ligji nr. 10 448, datë 9.6.2011 "Për lejet e mjedisit".
2. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për leje mjedisi të tipit "A" dhe "B" do të realizohet vetëm nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, urdhri nr. 908, datë 14.10.2013 "Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të kërkesave për pajisje me leje mjedisore", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka